



Nr. 1975/5 Prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Tiranë, më 07.08 2024

V E N D I M

Nr. 35 dt. 07.08 2024

“MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË STAFIT NDIHMËS AKADEMIK ADMINISTRATIVDHE PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS ”

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, neni 67 pika 1; në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; në VKM nr. 421, datë 26.06.2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 325, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, në Vendimin nr. 422, datë 26.06.2024 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuara, pika 1, gërma (m) “Punonjësve mbështetës dhe punonjësit e tjerë të specialiteteve të ndryshme”
Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 07.08.2024,

V E N D O S I :

1. Miratimin e nivelit të pagave të stafit ndihmës akademik dhe administrativ në IAL publike si tabela më poshtë vijon;

Pozicioni	Kategoria e pages sipas (VKM nr. 325/2023) dhe VKM nr. 421/2024)	Paga e pozicionit (VKM nr. 325/2023) (Ishte)	Paga e pozicionit (VKM nr. 421/2024) (Bëhet)
Përgjegjës Sektori, Kryetar dege në Rektorat	III-3	95 000	98,000
Specialist në Rektorat, Administratë, Klasifikator dhe Specialist në Fakultet	IV-2	70,000	80,000

2. Punonjësit që kanë përfunduar Master Profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, vlera e shtesës së kualifikimit nga 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj bëhet 14 000 (katërbëdhjetë mijë) lekë.
3. Punonjësve mbështetës dhe punonjësit e tjerë të specialiteteve të ndryshme” u jepet shtesë në masën 4 000 (katër mijë) lekë në muaj.
4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i VKM nr. 421, datë 26.06.2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 325, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nënpunësve civil dhe nënpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 422, datë 26.06.2024 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 326, datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuara, pika 1, gërma (m) “Punonjësve mbështetës dhe punonjësit e tjerë të specialiteteve të ndryshme”, fillon nga data 1 Korrik 2024 dhe përballohet nga fondi i kontigjencës
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UST-së, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit të UST-së.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI

